



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 40, paragrafi 2, pika (b) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr-03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 27/2008), e konform nenit 29 lidhur me nenit 54 dhe 56, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M
Për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e
Suharekës për vitin 2027–2029

Neni 1

Me këtë vendim miratohet korniza afatmesme-buxhetore për Komunën e Suharekës për vitin **2027 – 2029 (në tekstin e mëtejme KAB-i)**.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendim është edhe korniza afat mesme buxhetore 2027-2029 dhe lista e projekteve kapitale e viti 2027.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ec Bexhet KUÇI